

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”.

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, propozon që shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 %, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, të aplikohet edhe për ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike.

Ky propozim do të mundësojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues midis ofruesve të shërbimeve audiovizive dhe elektronike.

Aktualisht media elektronike dhe ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike që operojnë në tregun mediatik, nuk rregullohen nga ligji nr. 92/2014. Për këtë arsye, ndryshimi i propozuar konsiston, në përfshirjen e furnizimit të shërbimit të ofruesve të shërbimit të publikimeve elektronike, në skemën e shkallës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Për sa më sipër, projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, propozon që shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar 6 %, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, të aplikohet edhe për ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike.

Ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 53, gërma “j”, deri në datën 31 dhjetor 2018, i trajtonte si furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja, transaksionet pra furnizimin/shitjen e shërbimit të reklamave nga media elektronike.

Në zbatim të parimeve të vendosura përmes ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, subjektet që kryejnë furnizime të përjashtuara, nuk mund të zbresin TVSH-në e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, ndryshe nga subjektet që kryejnë furnizime të tatueshme dhe zbresin TVSH-në e paguar në blerje. TVSH-ja e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import në këtë rast, është kosto për ofruesit e këtyre shërbimeve.

Paketa fiskale e miratuar në vitin 2018, përmes së cilës u miratuan edhe disa ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pati për qëllim ndër të tjera, lehtësimin e investimeve në funksion të digjitalizimit të mediave audiovizive (televizionet). Kështu furnizimi i shërbimit të reklamave nga media audiovizive, nuk do të trajtohet më si një furnizim i përjashtuar, por si furnizim i tatueshëm me shkallën e reduktuar të TVSH-së prej 6 për qind.

Për të mundësuar gjithë sa më sipër, projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, propozon, që në nenin 49, pika 6 të ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shtojë edhe përcaktimin “ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike”. Kësisoj, do të kemi trajtim të njëjtë në lidhje me furnizimin e shërbimit të reklamave, si nga media audiovizive ashtu dhe nga ofruesit e shërbimit të publikimeve elektronike.